

V E N D I M

“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

*Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e përbërë nga :*

*GJYQTARE : REZARTA BALLIU (VIGANI)*

Me pjesëmarrjen e prokurorit Ndini Tavani, asistuar prej sekretares gjyqësore Loreta Merepeza, në datë 23.07.2015 mori në shqyrtim , kërkesën penale me:

KERKUESA : *D.K.*, i biri i A. dhe B., datl.19..., lindur në Fier dhe banues në Tiranë, Lagjia “A....”, Pall....., Hyrja 13;

*F. K.*, i biri i A. dhe B., datl.19.., lindur në Fier dhe banues në Tiranë, Lagjia “A.....”, Pall....., Hyrja 13;

*Shoqëria “F.....” sh.p.k.*, person juridik, me seli në ....., Lagjia ..... Rr.”K.....”, Pall.8, Kati 3, me përfaqësues ligjor Z.D. K.,

Kërkuesat përfaqësohen në gjykim me prokurën e posaçme Nr.1062 Rep e Nr.712 Kol, datë 02.06.2015 nga Av. Bujar Himçi me Nr.285 Liçense dhe NIPT: K 70200003 P dhe Av.Sokol Hazizaj me Nr.1188 Liçense dhe me NIPT: 72111028 T.

OBJEKTI : Heqje e masës së sekuestros preventive të vendosur me vendimin Nr.... Akti datë 17.04.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me anë të të cilit është vendosur sekuestro preventive në llogaritë bankare në emër të shtetasve D. K., F. K. dhe shoqërisë “F.....” sh.p.k., pranë ProCredit Bank sh.a.

BAZA LIGJORE: Neni 274/3 i K.Pr.Penale.

1. *Gjykata pasi shqyrtoi kërkesën e kërkuësve , të cilët kërkuan pranimin e kërkesës, prokurorin i cili e la në cmim të gjykatës kërkimin e kërkuësve dhe pasi e bisedoi dhe shqyrtoi çështjen në tërësinë e saj,*

## V Ë R E N

Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, mbi bazën e materialeve të ardhura nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Tiranë, ka regjistruar procedimin penal Nr..... të vitit 2015, për veprën penale të *“Pastrimit të produkteve të veprës penale ose i veprimtarisë kriminale”*, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal .

Nga hetimet paraprahe ka rezultuar se, shtetasi D. K., ka krijuar shoqërinë *“F.....”* sh.p.k në Shqipëri dhe nëpërmjet kësaj shoqërie ky shtetas dhe familjarët e tij kanë kryer transaksione në vlera të larta ku rezultojnë transferta hyrëse në vlera të konsiderueshme nga shoqëritë në Itali *“D.....”* Srl dhe *“A.....”*, (në një vlerë totale për 2013-2015 afërsisht 15 mln EURO) .

Këto shuma të përfituara janë transferuar kryesisht drejt Zvicrës me përshkrime *“Trafik telefonik”* sipas kontratës, por edhe për shërbime konsulence në shoqëri me seli në vende të ndryshme si Kinë. Angli etj.

Për vërtetimin e burimit të fondeve dhe përdorimin e tyre në bankë ,shtetasi D. K. ka deklaruar se, pajisjet për shërbimet që kryen i ka të vendosura në Zvicër. Ne ambientin që ka biznesin në Shqipëri, nuk ka asnjë pajisje të cilat mund të shërbenin për të kryer trafikun e shërbimit telefonik.Nuk zotëron ndonjë liçencë profesionale për ushtrimin e aktivitetit në Shqipëri dhe se aktiviteti i tij nuk ka nevojë për liçencim nga asnjë autoritet shqiptar të tilla si A.K.E.P apo ndonjë tjetër.

Në datë .....2013 (*10 ditë pas krijimit*) shoqëria *“F.....”* sh.p.k., (pala blerëse) e përfaqësuar nga D. K., ka lidhur kontratë me shoqërinë *“S.....”* (pala shitëse) e përfaqësuar nga V. J. dhe A. F.. Objekt i kësaj kontratë është të shesë/blejë të njëra-tjetra trafik telefonik kombëtar dhe ndërkombëtar. (kjo kontratë është depozituar në të dy bankat *“Union”*sh.a. dhe *“ProCredit”*sh.a).

Në datë 16.12.2014, shtetasi F. K. së bashku me shtetasen A. N. K. si palë blerëse, kanë lidhur kontratë blerje për rezervim apartamenti në vlerën 90.000 EUR0. Pala sipërmarrëse është shoqëria *“S.....”* sh.p.k me NIPT

J.....O, e përfaqësuar nga shtetasi N.M.. Të ardhurat janë deklaruar nga puna në emigracion.

Po në datë 16.12.2014, shtetasi F. K. si palë blerëse ka lidhur kontratë blerje garazh në vlerën 10.000 EURO. Pala sipërmarrëse është shoqëria "S....." sh.p.k me NIPT J.....O, e përfaqësuar nga shtetasi N. M.. Të ardhurat janë nga puna në emigracion.

Në datë 19.01.2015, shtetasi D. K. së bashku me shtetasen E. P. Th., si palë blerëse kanë lidhur kontratë për prenotim apartamenti në vlerën 104.000 EURO. Pala sipërmarrëse është shoqëria "K....." sh.p.k me NIPT K.....U, e përfaqësuar nga shtetasi S. K..

Nga verifikimi në Q.K.R në emër të këtyre shtetasve rezultoi se, në datë .....2011, D. K. ka krijuar biznesin "D....." P.F me NIPT L... A. Objekti i veprimtarisë është: "*Grumbullim të frutave pyjore, boçeve të pyjeve dhe rrëshirës së pishave. Mbarështrimin e faunës së egër pyjore dhe ushtrimin e gjuetisë turistike, eksport - import të produkteve të faunës së egër, eksport - import të produkteve të dyta pyjore, boçeve të pishës dhe llojit xine. Krijimin e rezervateve për shpendë e kafshë të egra dhe administrimin e tyre. Import eksport të produkteve bujqësore, inpute bujqësore dhe amballazhim. Import-eksport të materialeve të ndërtimit, import-eksport të lëndëve drusore etj*". Adresa e biznesit është: ..... , Lagjja ".....", Rruga " J.....", Godine 3 katëshe, kati i 1, pranë kompleksit "M.....".

Në datë .....2012 D. K. dhe F. K., kanë krijuar shoqërinë "F.....sh.p.k, me NIPT L.....A. Objekti i veprimtarisë së kësaj shoqërie është: "*Ndërtim civile dhe industriale, rikonstruksion godinash, veshje fasadash etj. Punime dheu, sistemime, tarracime terrenesh, vepra kullimi dhe vaditëse. Ndërtim rrugë kat. 4 dhe 5, veshje rrugësh me asfalt-beton, ndërtim mbishtrese etj*", ndërkohë që në datë 13.05.2012, (pas një muaji që ishte krijuar) shoqëria kalon në proces likuidimi.

Në datë .....2013, është krijuar shoqëria "**F.....**" **sh.p.k.** me NIPT L.....F, me kapital fillestar 100.000 Lekë .Objekti i veprimtarisë së kësaj shoqërie është: "Shitje blerje, tregtim të trafikut telefonik me shumicë" dhe adresa është në ....., Lagja ".....", Rr."K.....", Pallati 8, Kati 3-të.

Shtetasit e mësipërm dhe shoqëritë që ata kanë krijuar , kanë kryer veprime financiare (blerje, shitje, transferime kapitali), ndërkohë që në emër të shoqërisë "F....." sh.p.k rezultojnë transaksione të kryera në bankën "Union"sh.a. dhe "ProCredit"sh.a, transferta hyrëse dhe dalëse me

përshkrime për likuidim faturash trafik telefonik, tërheqje si dhe transferime ndërmjet llogarive në EURO dhe USD për këmbime valutore .

Prokuroria gjatë hetimit të këtyre shtetasve dhe bizneseve të tyre ka konstatuar se, këta shtetas dhe shoqëritë që ata kanë krijuar, kanë kryer transaksione me vlera të larta si dhe janë konstatuar disa anomali të kryera nga shtetasit e lartpërmendur nëpërmjet krijimit të disa aktiviteteve, që nuk janë produktive në vendin tonë.

Shoqëria “F.....” sh.p.k., është një subjekt i rregjistruar pranë organeve tatimore të Republikës së Shqipërisë dhe si i tillë është i detyruar sipas legjislacionit tatimor të paguajë tatimet lidhur me të ardhurat , fitimin dhe TVSH-në, sipas bilancit të faturave të realizuara në shitje dhe në blerje . Në çështjen objekt hetimi dyshohet se nga ana e subjektit nuk është bërë asnjë pagesë lidhur me tatimet e taksat.

Nga të dhënat e siguruara , Prokuroria ka çmuar se ka dyshime të bazuara në prova se, në rastin konkret pasuritë e shumta, janë produkte te veprave penale ose i veprimtarisë kriminale, të shtetasve D. K., F. K. dhe shoqërisë “F.....” sh.p.k., të cilat janë krijuar mbi bazën e të ardhurave të siguruara nga aktiviteti kriminal , nuk justifikohen nga pikëpamja ekonomike sepse nuk identifikohen burime të ligjshme të ardhurash për të siguruar këto pasuri.

Për këtë arsye, gjykata me kërkesë të organit të akuzës dhe bazuar në nenin 274/2 të Kodit të Proçedurës Penale, në datë 17.04.2015, me vendimin Nr..... Akti, ka vendosur:

*“ Pranimin e kërkesës së Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, si të bazuar në ligj dhe në prova .*

*Vendosjen e sekuestros preventive të llogarive bankare në emër të shtetasve D. K., F. K. dhe subjektit “F.....”, pranë Procredit Bank dhe konkretisht të shumës në euro depozituar dhe ndodhur në llogarinë:*

- A) EUR (.....002) shuma 751,345.71 EUR.
- B) LEK (.....101) shuma 6,778 LEK
- C) USD (.....003) shuma 705.31 USD “.

Pasi ky vendim është ekzekutuar, kërkesat me kërkesën drejtuar gjykatës kërkojnë heqjen e kësaj sekuestroje preventive të dhënë nga gjykata, për shkak se bllokimi i llogarive bankare ka sjellë ndërprerjen e aktiviteteve ekonomike të shoqërisë së tyre. Sipas kërkesave, shoqëria “F.....” sh.p.k. që ata kanë krijuar kryen shërbime dhe ka lidhur

kontrata me shoqëri të huaja dhe nëpërmet kësaj mase të vendosur, shtohen borxhet dhe sanksionet e kësaj shoqërie ndaj shoqërive të huaja.

Gjykata, pasi e shqyrtoi këtë kërkesë çmon se ajo është e bazuar në prova dhe në ligj, si e tillë duhet të pranohet.

Rezultoi e provuar se, që nga momenti i dhënies së vendimit nga gjykata, janë kryer hetime nga ana e organit të akuzës , në lidhje me këtë vepër penale për të cilën është vendosur sekuestroja.

Kështu:

I. Nga Akt ekspertimi i kryer në datë 18.05.2015 , në lidhje me aktivitetin e shoqërisë “F.....” sh.p.k.,i kryer në kuadër të këtij hetimi, me kërkesë të organit të akuzës, ka rezultuar se:

I. *Rregjistrimet kontabël të kësaj shoqërie janë të rregullta;*

II. *Përsa u përket pagesave të kryera nga shoqëria “F.....” sh.p.k. janë kryer vetëm në drejtim të subjekteve që ajo ju ka detyrime për shërbimet e kryera dhe ka kryer transaksione tërheqje dhe derdhje në llogari, me administrator D. K..Në asnjë rast nuk ka transaksion për të tretë që nuk janë kontraktor apo nuk kanë faturë për subjektin.*

III. *Shoqëria “F.....” sh.p.k. ka llogaritur dhe ka shlyer rregullisht detyrimet ndaj shtetit si për sigurimet shoqërore, taksat dhe tatimin mbi fitimin.Për vitin 2013-2014 detyrimet janë shlyer plotësisht sipas periudhave që janë afatet e përcaktuara.*

*Shoqëria “F.....” sh.p.k. për vitin 2015 nuk ka paguar të gjitha detyrimet, por është në vazhdim.*

IV. *Aktiviteti që kryen shoqëria “F.....” sh.p.k.,është trafik ndërkombëtar telefonik me shumicë . Nisur nga kontratat e lidhura midis palëve nuk është e nevojshme që subjekti patjetër të ketë aktivet e veta afatgjata sepse e kryen punën duke marrë server dhe pajisje të tjera me qera.*

V. *Pasqyrat financiare për vitin 2013-2014 janë deklaruar rregullisht pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore .....Brenda afateve ligjore.*

Akti i Ekspertimit ka konkluduar në përfundim se :”Nga kontrolli i rregjistrimeve kontabël dhe rregjistrimi i transaksioneve bankare, nuk ka transaksione jashtë listës së furnitorëve dhe klientëve të shoqërisë “F.....” sh.p.k.

*Pra rezulton se shoqëria “F.....” sh.p.k., ka një aktivitet normal dhe në përputhje me legjislacionin financiar”.*

II. Në kuadër të hetimeve për këtë çështje, organi i akuzës , i ka kërkuar ndihmë juridike Ministrisë së Drejtësisë Tunizisë dhe Zyrës Federale të Drejtësisë në Zvicër ,me shkresat Nr..... Prot dhe Nr..... Prot, në datë 16.07.2015, për të verifikuar vërtetësinë e disa kontratave të shërbimit dhe të konsulencës.

III. Mbas kryerjes së veprimeve hetimore, në lidhje me këtë çështje penale, organi i akuzës në datë 08.07.2015 ka vendosur, pezullimin e hetimeve të procedimit penal Nr....., të vitit 2015, për shkak se nuk është bërë e mundur zbulimi i autorit të veprës penale të “Pastrimit të produkteve të veprës penale ose i veprimtarisë kriminale”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal .

Në nenin 274/3 të K.Pr.Penale është parashikuar: *”Kur ndryshojnë kushtet e zbatimit, gjykata me kërkesën e prokurorit ose të të interesuarit, e heq sekuestron”.*

Përsa mësipër , gjykata në përfundim të shqyrtimit të kërkesës të kërkuarave , pasi analizoi të gjitha provat e paraqitura nga organi i akuzës çmon se, ajo duhet të pranohet si e bazuar në ligj dhe në prova.

#### PËR KËTO ARSYE

*Gjykata në bazë të nenit 274 të K.Pr.Penale ,*

#### V E N D O S I

I. Pranimin e kërkesës .

II. Heqjen e masës të sekuestrës preventive dhënë me vendimin Nr..... Akti datë 17.04.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë , të llogarive bankare , në emër të shtetasve D. K., F. K. dhe shoqërisë “F.....” sh.p.k, pranë “ProCredit Bank” sh.a dhe konkretisht të shumës në Euro depozituar dhe ndodhur në llogarinë:

I. EUR (.....002) shuma 751,345.71 EUR.

II. LEK (.....101) shuma 6,778 LEK

III. USD (.....003) shuma 705.31 USD .

1. Kundër këtij vendimi lejohet ankim brenda 10 ditëve në Gjykatën e Apelit Tiranë.

• U shpall sot me datë 23.07.2015 në Tiranë.

SEKRETARE

GJYQTARE

*(VIGANI)*

*Loreta MEREPEZA*

*Rezarta BALLIU*